

Nr. 7939/1 Prot.

Tiranë, më 04/11 2022

Drejtuar: **Z. Petrit AHMETI**
Kryetar
Enti Rregullator i Energjisë

Për Dijeni: **Znj. Belinda BALLUKU**
Zv/Kryeministre dhe Ministre
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Z. Ergys VERDHO
Administrator
Korporata Elektroenergjitike Shqiptare

Z. Adrian ÇELA
Administrator
Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group

Lënda: **Lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë për Muajin Nëntor 2022.**

I Nderuar Z. Ahmeti,

Me shkresën Nr. 4820/12 Prot, datë 04.11.2022, regjistruar pranë Furnizuesit të Shërbimit Universal SH.A me Nr.7939 prot, datë 04.11.2022, Korporata Energjitike Shqiptare ka njoftuar shoqërinë Furnizuesi i Shërbimit Universal SH.A për Vendimin Nr. 8363/1 datë 04.11.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit ka miratuar Vendimin Nr.14, datë 01.11.2022 të Këshillit Mbikqyrës “Për pezullimin e aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU SH.A për muajin Nëntor 2022”, në të cilin është vendosur:

“1. Pezullimi i aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU SH.A, miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës Nr.07, datë 07.09.2022 dhe Vendimit të Asamblesë së Aksionarëve Nr.6645/1, datë 08.09.2022 për muajin Nëntor 2022 dhe vijimin e tarifimit për shitjen e energjisë për FSHU SH.A, sipas tabelës më poshtë:

Energji e shitur për konsum familjar në TU	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum jo familjar në TU	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë në Tension të mesëm TM, 6/10/20 KV	12 ALL/KWh

Enti Rregullator i Energjisë me vendimin Nr.242, datë 23.09.2022 “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU SH.A lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kWh në muaj”, të ndryshuar me Vendimin Nr.254, datë 07.10.2022 vendosi: “*Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 42 lekë/kWh për konsumin mbi 800 kWh/muaj për klientët familjar për periudhën 1 Nëntor – 31 Dhjetor 2022...*”

Kërkesa e Shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU SH.A.) për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për konsumin e energjisë elektrike mbi 800 kWh/muaj për klientët familjarë, është bërë për arsye të rritjes së kostos së blerjes së energjisë elektrike që prokurohet për qëllime të mbulimit të nevojës së FSHU SH.A. nga KESH SH.A, mbështetur në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të kësaj të fundit Nr. 6645/1, datë 08.09.2022, në të cilën ishte vendosur që çmimi për energjinë e klientëve familjarë për konsumin mbi 800 kWh/muaj të ishte **34.3 Lekë/kWh**.

Në kushtet kur nga organet vendimmarrëse të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH SH.A) është vendosur pezullimi i aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU SH.A të miratuara me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës Nr.07, datë 07.09.2022 për muajin **Nëntor 2022**, duke u lënë në fuqi i njejt çmim i shitjes së energjisë për konsumatorët familjarë **prej 2.6 lek/kWh**, kostot e blerjes së energjisë elektrike për FSHU SH.A për këtë kategori konsumatorësh për muajin **Nëntor 2022** ngelen të pandryshuara.

Për sa më sipër, vlerësojmë se këto kosto duhet të reflektohen në përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë të energjisë për klientët familjarë (pavarsisht nivelit të konsumit) **për muajin Nëntor 2022**, duke u aplikuar çmimi i përcaktuar me vendimin Nr.74, datë 23.04.2022 të Entit Rregullator të Energjisë.

Bashkëlidhur shkresa e KESH SH.A me Nr.4820/12 prot, datë 04.11.2022.

Në pritje të vendimmarrjes suaj.

Me konsideratë,

Elton SEVRANI
Administrator
FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL SH.A



Nr. 4820/12 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 04/11/2022

LËNDA: Për miratimin e tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a.

DREJTUAR:

FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL SH.A. ✓

PËR DIJENI:

OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

I Nderuar Z. Sevrani,

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të shoqërisë KESH sh.a (Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e përfaqësuesit të Autoritetit Publik (MIE) që përfaqëson pronën shtetërore sipas VKM-së Nr.317/2016) me shkresë Nr. 6490/1 Prot, datë 06.09.2022, në vijim të trajtimit të kërkesave të shoqërisë për vijimin e mbështetjes buxhetore, kërkoi për shoqërinë marrjen e masave në aplikimin dhe përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike me fasha konsumi, mbi 800 KWh/muaj për klientët familjar.

Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 07.09.2022, me Vendim Nr. 07 Këshillit Mbikëqyrë miratoi propozimin për tarifën e propozuar nga ana e shoqërisë, i cili është miratuar me Vendim Nr. 6645/1, datë 08.09.2022 të Asamblesë së Aksionarëve në përputhje me parashikimet e Vendimit Nr. 456, datë 29/06/2022 të Këshillit të Ministrave, sqaruar edhe në relacion për një periudhë aplikimi të tarifave deri më 31.12.2022.

Në vijim të përditësimit të situatës së veprimtarisë së shoqërisë KESH sh.a. dhe të dhënave të paraqitura nga tregjet e energjisë dhe kërkesës së FSHU sh.a. për furnizim me energji elektrike për muajin Tetor, Me vendim të Asamblesë së Aksionarëve, u miratua pezullimi i aplikimit të tarifimit për energji të konsumuar nga klientët familjar mbi 800 KWh/Muaj, për muajin nëntor 2022 dhe vendosjen për këtë muaj të tarifës Energji e shitur për konsum klientë në TU, 2.6 ALL/KWh, Energji e shitur për konsum klientë në Tension të mesëm TM, 6/10/20 KV, 12 ALL/KWh dhe vijimin e aplikimit të tarifës së miratuar me Vendimin Nr. 07, datë 07.09.2022, për periudhën 01.12.2022 – 31.12.2022

Bashkëlidhur, ju përcjellim për vijimin e proceseve të nevojshme të miratimit të tarifave, Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të shoqërisë KESH sh.a. për caktimin e tarifës së energjisë të furnizuar për shoqërinë FSHU sh.a., sipas klientëve universal të cilët furnizohen nga FSHU sh.a.

Me respekt,

Concession

ADMINISTRATORI

Ergys VERDHO



Nr. 422e/9 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 01 / 11 / 2022

VENDIM

Nr. 14 , Datë 01 / 11 / 2022

PËR PEZULLIMIN E APLIKIMIT TË TARIFAVE TË SHITJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR FSHU SH.A. PËR MUAJIN NËNTOR 2022

Në mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Vendimit Nr. 456, datë 29.06.2022, të Këshillit të Ministrave, dhe shkresës Nr. 6490/3 Prot., datë 29.09.2022, protokolluar pranë KESH sh.a. Nr. 4820/1 Prot., datë 30.09.2022, dhe relacionit të shoqërisë Nr. 4820/8 Prot., datë 31.10.2022, në mbledhjen e datës 01.10.2022,

VENDOSI:

1. Pezullimin e aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a., miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës Nr. 07, datë 07.09.2022 dhe Vendimit të Asamblesë së aksionarëve Nr. 6645/1, datë 08.09.2022, për muajin Nëntor 2022 dhe vijimin e tarifimit për shitjen e energjisë për FSHU, sipas tabelës më poshtë:

Energji e shitur për konsum klientë familjar në TU	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë jo familjar në TU	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë në Tension të mesëm TM, 6/10/20 KV	12 ALL/KWh

2. Aplikimin e tarifave për periudhën pas pezullimit deri më 31.12.2022 si miratuar në vendimin Nr. 07, datë 07.09.2022, miratuar me Vendim të asamblesë së aksionarëve Nr. 6645/1, datë 08.09.2022.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të KESH sh.a.
4. Ngarkohet Administratori i shoqërisë për zbatimin e këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKQYRËS

Evis MAMAJ

Ani HASA
Anëtar

Ylber MUCEKU
Anëtar

Arta GURABARDHI
Anëtare

Luigj PJETRI
Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT

Nr. 8363/1, datë 04.11.2022

“PËR PEZULLIMIN E APLIKIMIT TË TARIFAVE TË SHITJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR FSHU SH.A PËR MUAJIN NËNTOR 2022”

Mbështetur në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), VKM nr.317, datë 27.04.2016 “Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike, Statutin e shoqërisë, VKM nr.456, datë 29.06.2022 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr.6645/1, datë 08.09.2022 “Për miratimin e tarifave të shitjes së energjisë elektrike për shoqërinë FSHU sh.a”, pas shqyrtimit të vendimit nr.14, datë 01.11.2022 të Këshillit Mbikëqyrës, bashkëlidhur shkresës tuaj nr.4820/10prot., datë 02.11.2022, në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “KESH” sh.a,

VENDOSA:

1. Miratimin e vendimit nr.14, datë 01.11.2022 të Këshillit Mbikëqyrës “Për pezullimin e aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për shoqërinë FSHU sh.a, për muajin Nëntor 2022”.
2. Ngarkohet Administratori i shoqërisë “KESH” sh.a për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE
MINISTËR

Belinda Balluku

TIRANË

KESH

ENERGJIA E SHQIPËRISË

Nr. 4820/8..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 31/10/2022

KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË KESH SH.A.

RELACION

PËR VLERËSIMIN E SITUATËS FINANCIARE TË SHQËRISË PËR MUAJIN SHTATOR
2022 DHE PERIUDHËN DERI NË 31.12.2022 LIDHUR ME APLIKIMIN E MASAVE TË
NEVOJSHME TARIFIMIT ME FASHA KONSUMI TË KLIENTËVE FUNDOR FAMILJAR

Nr. _____, Datë _____

Shtator 2022

1. ECURIA E REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE TË SHOQËRISË PËR 96 MUJORIN E PARË TË VITIT 2022

1.1 Vlerësimi i bërë në vitin 2021 mbi pritshmërisë për vitin 2022 (analiza e bërë dje (2021) në këndvështrimin e sotëm).

Në 04 Tetor 2021, qeveria Shqiptare shpalli nëpërmjet VKM Nr.584/2021, gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike, për shkak të çmimeve të energjisë elektrike në tregje dhe situatës hidrike në Kaskadën e Drinit.

Në këtë fazë të gjendjes së emergjencës shoqëria KESH nuk gjendej përpara asnjë efekti të drejtpërdrejtë duke qenë se detyrimi për shërbim publik i vendosur për KESH sh.a. vijon të jetë vetëm ai i shitjes së energjisë së prodhuar nga HEC-et në kaskadën e Drinit.

Për trajtimin dhe menaxhimin e situatës së emergjencës Këshilli i Ministrave me VKM Nr. 620/2021, përcakton për shoqëritë publike të sektorit energjetik, disa detyrime dhe të drejta, nga të cilat shoqëria KESH vijon të mbetet e pa detyrime të shtuara për shërbim publik.

Nëpërmjet VKM Nr. 757/2021, për disa ndryshime në VKM Nr. 620/2021, situata e detyrimit për shërbim publik e cila i vendoset KESH sh.a. ndryshon në tërësi nëpërmjet të cilave Këshilli i Ministrave rishpërndan detyrimin për shërbim publik mes shoqërive publike të sektorit si dhe përcakton për shoqëritë instrumentet që mund të përdoren për përballimin dhe menaxhimin e situatës së emergjencës, nga të cilat konkretisht, për kesh sh.a. përcaktohen:

- Shoqëria KESH i furnizon shoqërisë FSHU të gjithë sasinë e nevojshme të energjisë.
- Shoqëria KESH sh.a. ka të drejtën e qiramarrjes së aseteve gjeneruese termike për periudha të përkohshme
- Shoqëria KESH sh.a. ka të drejtë të blejë energji elektrike për qëllime të përmbushjes së detyrimit ndaj FSHU

Mbi bazën e sa më sipër si dhe të dhënave shumëvjeçare të shoqërisë KESH sh.a. për prodhimin në kaskadën e lumit Drin, shoqëria KESH sh.a. përgatiti parashikimet e saja ekonomiko financiare për përmbushjen e detyrimit për shërbim publik të vendosur.

Konkretisht shoqëria KESH sh.a. bazuar në të dhënat e përcjella nga ana e FSHU sh.a. në fund të vitit 2021, lidhur me konsumin vjetor të parashikuar në vend nga klientët fundorë të ndarë sipas kategorive Familjar në TU, biznes në TU, Biznes në TM (nivel tensioni 6/10/20 KV).

Në premisat e shoqërisë u morën në konsideratë:

- Konsumi i parashikuar nga FSHU për klientët si më sipër 5.75 TWh/Vit
- Gjenerimi i KESH nga kaskada sipas të dhënave mesatare shumë vjeçare në total 3.95 TWh/vit
- Përcaktimi i nevojës për import 1.8 TWh
- Vlerësimi i kostove të importit bazuar në të dhënat mesatare shumë vjeçare dhe pritshmërisë të tregut me një normë korrektuese prej 40%.
- Përcaktimi i çmimit të shitjes për FSHU në varësi të klientëve lidhur në TU me 2.6 Lekë/KWh dhe TM 12 Lekë/KWh

Skenari BAZE PEF		
Treguesit vjetor		Totali
niveli Fierze fillim muaji, mmnd		284.49
niveli Fierze fund muaji, mmnd		
Energji per TU		4,630,828
Energji er TM		1,071,915
Kerkesa e FSHU, MWh		5,702,744
Gjen_kaskad_ prurjet natyrore, MWh		3,950,000
Imp_forward		1,752,744
Crimi ne Import Euro/MWh		95
Kosto energji e importuar		166,510,680
Portofoli 2022 (EUR)		
Treguesit vjetor		Totali
te ardhura_Furnizim TU 21.48 EUR/MWh		99,470,185
te ardhura_Furnizim TM 100 EUR/MWh		107,191,500
Kosto energji e importuar EURO		166,510,680
Bilanci blerje shitje energji		40,151,005
Shpenzime operacionale		28,213,940
Rezultati financiar pa Investime		11,937,066
Shpenzime Amortizimi		29,841,405
te ardhura Sherbime Ndhimese dhe Optimizim		20,000,000
Rezultati		2,095,661

1.2 SITUATA E 9 MUJORIT TE PARE 2022

- Situata hidrike**

Fillimi i vitit 2022 u karakterizua nga reshje të pakta nën mesataren shumëvjeçare deri në 55% më pak të cilat vendosën shoqërinë në vështirësi për përmbushjen e detyrimit për shërbim publik dhe e ekspozuan edhe më shumë në tregjet e energjisë.

Bazuar ne prodhimin faktik te periudhës Janar-Mars parashikohet qe prodhimi bruto i energjisë elektrike për vitin 2022 të rishikohet me ulje për një total prej rreth 3.6 TWh ose 0.4 TWh me pak kundrejt planit të miratuar për vitin 2022.

Si rrjedhoje lind nevoja për rishikimin e planit te prodhimit si dhe planit të importit të energjisë në tregje, duke patur parasysh administrimin e kujdesshëm të prurjeve si dhe garantimin e rritjes graduale dhe të qëndrueshme të rezervës energjetike të Kaskadës së Drinit, në atë masë sa të garantohet përmbushja e detyrimeve publike dhe në periudhat në vijim.

- Situata e tregjeve të energjisë**

Shoqëria KESH sh.a. parashikonte në programin e miratuar ekonomik të vitit 2022, që nevoja për blerje energjie në tregje, me qëllim përmbushjen e detyrimit për shërbim publik të ishte në nivelet e rreth 1.75 TWh me qëllim përmbushjen e detyrimit ndaj FSHU për një total vjetor prej 5.7 TWh.

Detyrimi prej 5.7 TWh do të përmbushej me 3.95 TWh energji të prodhuar në kaskadë dhe 1.75 TWh energji të importuar në tregjet e energjisë.

Me situatën hidrike të paraqitur në 3 mujorin e parë nevoja për energji nga tregjet tashmë është rritur me një shtesë prej rreth 0.54 TWh për një total prej 2.29 TWh energji për vitin 2022.

Çmimet e parashikuara të energjisë në tregje ishin në nivelin e 11.5 Lekë/KWh ndërkohë që situata e ndikuar edhe nga lufta në Ukrainë, paraqiti çmime të energjisë në tregje në nivele prej mbi 30 Lekë/KWh.

Pritshmëria për periudhën vijuese e çmimeve të energjisë në tregje sipas bursës së referencës Hungarian Power Exchange, vijon të mbetet për çmime të larta në nivelin e mbi 30 Leke/KWh edhe për periudhën në vijim të tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2022 si dhe për tremujorin e parë të vitit 2023, cka tregon për një pritshmëri me siguri të lartë me shtrirje edhe për vitin 2023

- **Masat për administrimin e efekteve të hidrologjisë dhe çmimeve të tregjeve**

Gjendur në kushtet e një viti të thatë hidrik dhe me energji me çmime të larta në tregje, shoqëria KESH sh.a. ndërmoi veprimet për menaxhimin e situatës së krijuar dhe efekteve të kësaj situatë nëpërmjet masave si më poshtë:

- Blerje e energjisë në avancë.
- U realizua kontraktimi për qiramarrjen e një asemi gjenerues termik, në zbatim edhe të parashikimeve të VKM Nr. 620/2021, me qëllim garantimin e sigurisë në furnizimin me energji elektrike nga gjenerimi brenda vendit dhe ulje e ekspozimit në tregjet e energjisë.
- U përmbyll procesi i ndërtimit të asemi gjenerues fotovoltai në HEC Vau i Dejës, me kapacitet të instaluar prej 5 MW.
- U shfrytëzua, në kushtet e parablerjes së energjisë, rezervë energjetike e akumuluar në rezervuarin e HEC Fierzë.

Në përfundim të procesit shoqëritë Exelerate Energy dhe Renco, u shpallen fituese për thirrjen e publikuar dhe vendosjen në zonën e Triportit, Vlorë të një asemi gjenerues termik me kapacitet të instaluar prej 110 MW.

- **Rezultati i masave të marra**

Nga masat e mara shoqëria arriti të përballojë me sukses periudhën e vështirë të tremujorit të parë të vitit, me rezultate si më poshtë.

- Ulje e ekspozimit në tregje.

Përdorimi i rezervës energjetike gjatë këtij muaji u realizua duke marrë në konsideratë edhe (i) sjelljen konsumatorë të muajve Prill, Maj dhe Qershor, e cila pëson ulje të ndjeshme, (ii) eventet e reshjeve dhe rritjes së temperaturave që sjellin rritje të prurjeve nga shkrirja e dëborës dhe ujit në muajin Prill dhe Maj dhe (iii) rritje e gjenerimit në muajit Prill dhe Maj i prodhuesve me përparësi, prodhim që e tejkalon nevojën për mbulimin e humbjeve (iv) rritje të gjenerimit nga burimet e rinovueshme kryesisht fotovoltai dhe nga era, në rajon dhe Europë. Tërësia e këtyre faktorëve do të sillte si efekt (i) kërkesë më të ulët konsumatorë në muajit në vijim (ii) prodhim të shtuar nga gjeneruesit me përparësi, (iii) prodhim të shtuar në europë nga burimet e rinovueshme dhe rrjedhimisht çmime më të ulëta të energjisë në periudhën Prill- Qershor se në periudhën e muajt Mars.

Totali i llogaritur i kursimit nga ulje e ekspozimit në tregje dhe përdorimi i rezervës energjetike për muajin Mars është në rreth 35 Milion Euro.

- Rritje e rezervës energjetike si rrjedhojë e menaxhimit të prodhimit vendas

Planifikimi i prurjeve, Konsumit dhe gjenerimit nga prodhuesit me përparësi sollën si rezultat që të riakumulonte rezervë në HEC Fierzë për periudhën e thatë të vitit Tremujori i tretë dhe i Katërt. Në fillim muajin Korrik shoqëria kishte një rezervë energjetike prej 1.1 TWh në HEC Fierzë.

Kjo rezervë po përdoret për përballimin e konsumit për periudhën vijuese, në këtë mënyrë duke synuar përdorimin e rezervës sërish gjatë periudhave me risk të lartë të ekspozimit në tregje.

- Menaxhim i kostove të energjisë së nevojshme për përmbushjen e detyrimit për shërbim publik.

Shoqëria KESH sh.a. ka arritur deri më sot që të përballojë ekspozimin në tregjet e energjisë elektrike me ekonomikitet si rrjedhojë e veprimeve të mësipërme, si dhe të bëjë të mundur akumulimin e rezervës së nevojshme e cila do të përdoret për përballimin e situatave në periudhën e thate të vitit 2022.


Këtë rezultat financiar shoqëria ka arritur për sa përshkruar më sipër por edhe si rrjedhojë e kërkimit në tregje të produkteve të energjisë që kanë çmime më të ulëta (profilet e energjisë në tregje), kryesisht duke kombinuar me profile energjie off-peak.

1.3 Raporti plan-fakt 9 mujori i pare (pikat e dobëta sa dhe si rezultuan te tilla plus pika te tjera te shfaqura)


(a) Treguesit e Realizimit Të Veprimtarisë Së Prodhimit Dhe Tregtimit

Sikurse vërehet edhe nga grafiku i mëposhtëm, Niveli mesatar i shfrytëzimit si dhe prurjet gjate 6-mujorit te pare janë me te ulëta se mesatarja e tyre për periudhën 16 vjeçare.

Grafiku 1. Prurjet në Fierzë dhe Niveli Mesatar i Shfrytëzimit për periudhën deri tetor 2022 dhe parashikim.




Grafiku 2. Rezerva Energetike dhe Prodhimi për deri Tetor 2022



Grafiku tregon prodhimin bruto të realizuar gjatë 9 mujorit të pare i cili ka një ulje rreth

16 % krahasuar me prodhimin mesatar të periudhës shumëvjeçare.

PRODHIMI 2022




Prodhimi bruto i energjisë për periudhën 9-mujore është afërsisht 15% më i ulët se parashikimi në planin e miratuar të gjenerimit, kjo si rrjedhojë e të dhënave hidrologjike të cilat paraqiten në 45% më të ulët se mesatare shumë vjeçare.

Korporata në këto kushte, ka kryer volume të tregtimit të energjisë duke përfshirë blerjen në tregun e parregulluar, shkëmbimin, optimizimin dhe shkëmbimin e energjisë balancuese, duke u orientuar dhe qenë më aktive në treg. Konkretisht realizimi i blerjeve në treg të parregulluar është realizuar me një ulje prej rreth 8%, kjo si rrjedhojë se për muajt Prill, maj dhe Qershor nevoja e FSHU është përmbushur nëpërmjet tepricave të HEC-eve të vogla.

1.4 2.4 Treguesit ekonomik – financiarë të realizuar për 6 mujorin e parë 2022

Tabela në vijim pasqyron në mënyrë analitike realizimin faktik të treguesve financiarë të 6- mujorit të parë 2022 të krahasuar me programin e miratuar për të njëjtën periudhë.

Tabela 2.Pasqyra e Të Ardhurave dhe Shpenzimeve të 6- mujorit të parë 2022



PL Raporti Operacional 6-M | 2022

(Shumicat janë të shprehura në miliona lekë)	Programi 6-M 2022 (QMI planuar)	Realizimi 6-M 2022	Ndeshimi ndërmjet (Realizimi 6-M 2022)	Ndeshimi ndërmjet (Realizimi 6-M 2022)
Operacionet e vijueshëm				
- Të ardhura nga shitja e energjisë:	14,227,134.17	12,134,299.98	(2,092,834.19)	-14.71%
Shitjet e Energjise për klientët tariforë të OSHEE/FSHU	5,922,335.90	5,607,690.39	(314,645.51)	-5.31%
Shitjet e Energjise për klientët tariforë të FMF	6,236,208.00	4,063,740.00	(2,172,468.00)	-34.84%
Shitjet e Energjise për mbulimin e humbjeve të OSHEE	-	-	-	-
Shitjet e Energjise për humbjet e Transmetimit OST	-	-	-	-
Shitje energjie elektrike për humbjet e Transmetimit KOSTT	-	-	-	-
Shitjet e Energjise me çmime tregu dhe optimizim (eksport dhe tregu vendas)	389,501.95	321,180.42	(68,321.53)	-17.54%
Shitje Energjie për mbulimin e Disbalancave	23,439.36	45,965.83	22,526.47	96.11%
Të Ardhura Shërbime ndihmëse për OST	928,906.72	1,564,151.89	635,245.17	68.39%
Të Ardhura Shërbime ndihmëse për KOSTT	724,544.80	529,021.27	(195,523.53)	-26.99%
Të Ardhura të tjera energjie elektrike (ASHTA+NOA)	2,197.44	2,550.15	352.74	16.05%
- Të ardhura të tjera operationale	-	-	-	0.00%
Shuma e të Ardhurave Operative	14,227,134.17	12,134,299.98	(2,092,834.19)	-14.71%
- Materiale të para dhe të konsumueshme	102,785.22	54,768.53	48,016.69	-46.72%
- Blerje Energjie:	9,988,295.25	21,122,646.00	(11,134,350.75)	111.47%
Blerje Energjie Elektrike me çmime tregu (import dhe tregu vendas)	9,366,819.00	20,953,275.72	(11,586,456.72)	0.00%
Blerje Energjie Elektrike për optimizim (import dhe tregu vendas)	470,008.00	60,487.84	409,520.16	-87.13%
Kompesimi financiar për OSHEE për sasinë e energjisë të munguar	-	-	-	100.00%
Tarifë Transmetimi	3,446.25	2,888.70	557.55	-16.18%
Blerje Energjie për mbulimin e Disbalancave	86,066.40	63,722.55	22,343.85	-25.96%
Blerje Shërbime ndihmëse OST	61,955.60	42,271.19	19,684.41	-31.77%
Blerje Shërbime ndihmëse KOSTT	-	-	-	-
Shpenzime të tjera energjie elektrike	-	-	-	-
Shpenzime personeli	691,099.45	612,462.15	78,637.30	-11.38%
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	1,805,405.00	2,239,744.66	(434,339.66)	24.06%
Shpenzime të tjera operationale	587,335.68	342,599.80	244,735.88	-41.67%
Shuma e Shpenzimeve Operative	13,174,920.60	24,372,221.15	(11,197,300.55)	84.99%
Fitimi Operativ	1,052,213.57	(12,237,921.17)	(13,290,134.74)	1263.06%
Të ardhura financiare	72,449.97	471,844.14	399,394.18	551.27%
Shpenzime financiare	(339,024.07)	(251,061.06)	(87,963.00)	-25.95%
Shpenzime Financiare Neto	(266,574.10)	220,783.08	(487,357.18)	-182.82%
Fitimi para tatimit	785,639.47	(12,017,138.09)	(12,802,777.55)	-1629.60%
Kreditim i tatimit mbi fitimin	-	-	-	-
Shpenzime tatim fitimi	(117,845.92)	-	(117,845.92)	-100.00%
Fitimi neto i periudhës nga operacionet e vijueshëm	667,793.55	(12,017,138.09)	(12,684,931.63)	-1899.53%

Të ardhurat operative të realizuara gjatë 6 - mujorit të parë të vitit 2022 janë rreth 7,7 Miliardë lekë me një rritje prej 1% kundrejt planit të miratuar, nga të cilat:

- i. rreth 5,6 Miliardë lekë janë të ardhura nga shitja për OSHEE sh.a./FSHU me çmim 2.6 lekë/kWh;
- ii. rreth 4.,06 Miliardë lekë janë të ardhura nga shitja për klientët tariforë FMF me çmim 12.0 lekë/kWh;
- iii. rreth 2,1 Miliarde lekë janë të ardhura nga shërbimet ndihmëse në tregun e Kosovës dhe atë vendas,
- iv. Hua buxhetore në vlerën 67.5 Milion Euro
- v. Injektimi kapital në total prej 16 Miliard Lekë.

Në total të ardhurat kanë pësuar një ulje me rreth 2.1 Mld Leke si rrjedhojë e mungesës së të ardhurave për energji shitur për FMF e cila është në proces rakordimi bazuar në VKM nr. 456/2022.

Shpenzimet operative për 6-mujorin janë rreth 24 Miliardë lekë me një rritje të ndjeshme kundrejt atyre të planifikuara, si rrjedhojë e rritjes së shpenzimeve për blerje në tregun e parregulluar për efekt të rritjes së ndjeshme të çmimit të tregut të energjisë me 11 miliardë Lekë.

2. ECURIA E REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE TË SHOQËRISË PËR MUAJT GUSHT – SHTATOR DHE PRITSHMËRIA PËR PERIUdhËN DERI NË FUND TË VITIT 2022

2.1 Ecuria e periudhës Tetor - Nëntor 2022

Në bazë të parashikimeve të bëra nga ana e shoqërisë KESH sh.a. pritshmëria e prodhimit të energjisë nga kaskada, sasia e energjisë për import dhe çmimi i parashikuar i importit për periudhën Gusht dhe Shtator 2022, paraqiten si më poshtë.

- (a) Parashikimi/ i çmimeve të energjisë elektrike për periudhën vijuese Analizë e situatës aktuale të çmimeve

Situata aktuale në tregjet e energjisë paraqitet me çmime të energjisë së blerë nga KESH sh.a, është me vlera të ulëta të energjisë elektrike në tregje. Për muajin tetor çmimi i realizuar i KESH sh.a. për energji në tregje është në vlerën e 371 Euro/MWh, kjo në rreth 250 Euro/MWh më e lartë se çmimet e parashikuara në mes Qershorin 2022 dhe rreth 180 Euro më e ulët se parashikimi i bërë në muajin Shtator për periudhën deri në fund të vitit 2022.

Çmimet e pritshme për periudhën vijuese kanë qenë të parashikuara nga ana e shoqërisë në nivelin deri 320 Euro/MWh për muajin Nëntor dhe 380 Euro/MWh për muajin Dhjetor.

- (b) Parashikimi i nevojës nisur nga premiset e parashikimit gjenerim/import (skenari optimist/pesimist)

Shoqëria bazuar në të dhënat tregjeve për periudhën vijuese për vitin 2022 parashikon në 3 skenare të dhënat e mëposhtëme, energjetike dhe financiare:

Nr.	Te dhënat e tregjeve deri 31.12.2022	Skenari optimist	Skenari pesimist	Perspektivë
1.	Nevoja për Import deri 31.12.2022 MWh	540,000	450,000	650,000
2.	Çmimi i Importit EUR/MWh Mesatar	340	280	440
3.	Gjenerimi nga kaskada deri 31.12.2022 MWh	1,110,000	1,210,000	1,01,000
4.	Prurjet mesatare deri 31.12.2022 m3	200	240	180
5.	Kostot e Importit EUR	183,000,000	126,000,000	286,000,000

2022	Cash-flow Skenari BAZE viti	FAKT												PARASHIKIMI												(EUR)	
		Jan	Feb	Mar	Apr	Maj	Jun	Juli	Agu	Sep	Oct	Nov	Deg	Jan	Feb	Mar	Apr	Maj	Jun	Juli	Agu	Sep	Oct	Nov	Deg		Total
1	Gjendje muaji paraardhes	18,500,000	919,380	7,691,184	1,087,894	1,116,332	(2,448,230)	(19,562,537)	(26,357,076)	(7,982,399)	7,025,661	(16,613,936)															
2	Te arketueshime mujore nga shlyet e muajit paraardhes te pagueshime deri me date 30 te cdo muaji	18,027,313	17,205,058	10,562,236	13,040,600	13,116,950	15,291,954	17,472,068	18,790,204	15,139,773	13,772,888	17,188,148															177,607,893
3	Te arketueshime Shterhime Njihmese dhe optimizimi				500,000	1,500,000	500,000	1,666,667	1,666,667	1,666,667	1,666,667	1,666,667															10,833,333
4	Te arketueshime mujore Total (me TVSH 2+3)	21,632,776	20,647,030	22,274,603	10,248,720	17,540,220	18,950,345	22,966,481	24,546,245	20,167,728	18,527,466	22,625,778															226,129,471
5	Detyrime mujore bierje energji nga muaji paraardhes te pagueshime deri me date 30 te cdo muaji	32,677,830	48,312,688	39,409,325	11,444,582	15,514,998	27,981,557	76,322,877		57,894,070	60,400,232	50,202,236															420,160,395
6	Detyrime mujore bierje energji (me TVSH) nga muaji paraardhes te pagueshime deri me date 30 te cdo muaji	39,213,396	57,975,225	47,291,189	13,733,499	18,617,998	33,577,868	91,587,453		69,472,884	72,480,279	60,242,683															504,192,474
7	Detyrime mujore Shpenzime Operacionale dhe Tatim dhe Dogane							1,200,000	1,200,000	1,200,000	1,200,000	1,200,000															6,000,000
